



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/69
Datë: 13.04.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 Ligjit nr. 03/L-246 për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri, nenit 3 të Ligjit për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, Ligjit nr. 03/L-178 për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 08/2011 për Listën e Autorizuar të Pajisjeve për qëllime të veçanta të institucioneve shtetërore të sigurisë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Lista e Autorizuar për vitin 2012 për pajisje për qëllime të veçanta dhe klasifikohet si "Konfidenciale".
2. Qeveria pajtohet që ta përjashtojë nga fushëveprimi i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës për shkak të sekretit të ligjshëm dhe interesat e Sigurisë së Republikës së Kosovës, sipas kërkesës së Ministrisë së Punëve të Brendshme, të datës 27.03.2012, ref ZSP-MPB/2012, dhe në pajtim me Listën nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Obligohen Institucionet shtetërore të Sigurisë që të veprojnë në pajtim me listën e autorizuar.
4. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/69

Datë: 13.04.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2012, mori:

V E N D I M

1. Mandati i Grupit Ndërmintor për Decentralizim zgjatet deri me 30 shtator 2012.
2. Miratohen, ndryshimet e rekomanduara dhe Termat e Referencës së Grupit Ndërmintor për Decentralizim.
3. Ngarkohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe ministritë anëtare të Grupit Ndërmintor për Decentralizim për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/69
Datë: 13.04.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2012, mori:

V E N D I M - P Ë R F U N D I M T A R

Për ndryshimin dhe shfuqizimin e pjeshëm të Vendimit Përfundimtar nr.03/36 të datës 07.09.2011

1. Ndryshohet dhe shfuqizohet pjesërisht pika 1. e Vendimit Përfundimtar Nr.03/36 datë 07.09.2011.
2. Anulohen shpronësimet dhe vlerësimet me interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të Vendimit Përfundimtar Nr.03/36 datë 07.09.2011 pika 1, të cilat nuk preken nga ndryshimi i trasesë për ndërtimin e Autostradës Vërmicë-Merdare në segmentin e 5, Zonat Kadastrale Bllacë, Temeqinë dhe Bellanicë, sipas tabelave të bashkangjitura këtij vendimi si Aneksi 1.
3. Mbesin në fuqi shpronësimet dhe vlerësimet me interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të miratuara me Vendimin Nr.03/36 datë 07.09.2011 të cilat preken nga ndryshimi i trasesë për ndërtimin e Autostradës Vërmicë-Merdare në segmentin e 5, Zonat Kadastrale Bllacë, Temeqinë dhe Bellanicë, sipas tabelave të bashkangjitura këtij vendimi si Aneksi 2.
4. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH në mbështetje të Kuvendeve Komunale në territorin e të cilave gjenden zonat kadastrale, i dërgojnë vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.

5. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është akti i vlerësimit dhe tabelat në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
6. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkangjitura të këtij vendimi.
7. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
8. Vendimi hyn në fuqi datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/69

Datë: 13.04.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2012, mori:

V E N D I M - P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohen ndryshimet e bëra për shpronësimin me interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga ndërtimi i Autostradës Vërmicë-Merdare në segmentin e 5, Zonat Kadastrale Billacë, Temeqinë dhe Bellanicë, sipas tabelave të bashkangjitura këtij vendimi si Aneksi I.
2. Miratohen korrigjimet e bëra për shpronësimin me interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga ndërtimi i Autostradës Vërmicë-Merdare, segmenti 4 Zona Kadastrale Suharekë, Komuna Suharekë dhe Segmenti 1, 2 Zona Kadastrale Dushanovë, Komuna Prizren, sipas tabelave të bashkangjitura këtij vendimi si Aneksi II.
3. Miratohen shpronësimet shtesë për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga ndërtimi i rrugës Gjakovë-Prizren, Zona Kadastrale Landovicë, sipas tabelave të bashkangjitura këtij vendimi si Aneksi III.
4. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH në mbështetje të Kuvendeve Komunale në territorin e të cilave gjenden zonat kadastrale, i dërgojnë vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1, 2 dhe 3 të këtij vendimi.

5. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
6. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit dhe tabelat në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
7. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkangjitura të këtij vendimi.
8. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është i detyruar të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
9. Vendimi hyn në fuqi datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/69
Datë: 13.04.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 73 të Ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2012, mori:

V E N D I M

1. Miratohet Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Strategjinë nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/69
Datë: 13.04.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 13 paragrafit 2 të Ligjit 04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2012, mori:

V E N D I M

1. Ndahen mjete Financiare në vlerë prej 325,000.00 euro (treqindnjëzetepesë mijë) euro për Projektet e Shërbimeve për nevojat e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Rezerva e Qeverisë, dhe barten në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik në Kodin e Programit 11313, Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse.
3. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/69
Datë: 13.04.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2012, mori:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, familjes së z. Selver Haradinaj, i ndan mjete financiare në vlerë prej 9,500.00 (nëntë mijë pesëqind) euro.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Rezerva e Qeverisë, dhe barten në xhirollogarinë znj. Fikrije Haradinaj numër 1503001003458624, në bankën komerciale Raiffeisen.
3. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë